



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Nr. 1041/6 prot.

Vlorë, më 27.09.2018

VENDIM

Nr. 59, datë 6.09.2018

PËR

**MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE NË PROGRAMET E CIKLIT TË DYTË TË
STUDIMEVE "MASTER PROFESIONAL", FAKULTETI I EKONOMIË**

Mbështetur në pikën 6 në nenin 75, shkronjën dh të pikës 1 në nenin 38 në ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", shkronjën f të pikës 2 në kreun III të VKM-së nr. 31, datë 29.12. 2017 "Për përcaktimin e kriterëve, dokumentacionit dhe procedurave për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e programeve të studimit nga institucionet e arsimit të lartë", VKM nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", Senati Akademik në mbledhjen e datës 6.09.2018

VENDOSI:

1. Të miratojë propozimin e Fakultetit të Ekonomisë për ndryshime në programet e mëposhtme "Master profesional" për kalimin e tyre në program studimi të ciklit të dytë me 60 kredite në përshtatje me ndryshimet ligjore:
 - Master profesional në financë
 - Master profesional në kontabilitet
 - Master profesional ekonomiks në sipërmarrje
 - Master profesional në administrim publik
 - Master profesional në sipërmarrje në turizëm
 - Master profesional në marketing
2. Këto programe studimi do të zbatohen për vitin akademik 2018-2019.
3. MASR do të njoftohet me shkrim për ndryshimet e bëra në këto programe studimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK
Prof. Dr. Roland ZISI

